

VENDIM
Nr. 371, datë 29.5.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 594, DATË 9.10.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR PËR
ZHVILLIMIN E DIASPORËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- a) Për pjesën e mbetur të mandatit, sipas pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2018:
 - i) Znj. Fjoralba Caka emërohet në vend të Znj. Teuta Vodo, si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për drejtësinë;
 - ii) Z. Kostandin Shkurti emërohet në vend të Znj. Besa Shahini, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
 - iii) Znj. Kozeta Angjeliu emërohet në vend të Znj. Mimoza Hysa Çuliqi, si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për kulturën.
- b) Pas përfaqësuesit nga ministria përgjegjëse për kulturën bëhet shtesa, si më poshtë vijon:
 - “iv. Znj. Anila Hyka Smorgrav emërohet si përfaqësuese nga Këshilli Koordinues i Diasporës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe